

VENDIM
Nr.612, datë 12.9.2007

**PËR DHËNIE FONDI NDIHMË PARTISË SË PUNËS SË SHQIPËRISË,
E RIORGANIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000

“Për partitë politike”, të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një fondi prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh Partisë së Punës së Shqipërisë, të riorganizuar, si ndihmë financiare.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha